



British Embassy
Pristina

“Tjetri” që nuk ekziston

Informacionet e mangëta
dhe të njëanshme për krimet e luftës në Kosovë

Raport hulumtues mbi
përmbajtjen e publikuar
në vitin 2023 në fushën
e drejtësisë tranzicionale



BIRN
BALKAN INVESTIGATIVE
REPORTING NETWORK

TPNJ	Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish- Jugosllavi
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
PK	Prokuroria e Shtetit
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
ASHAK	Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
MD	Ministria e Drejtësisë
AMMKM	Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale të Kosovës
FDH	Fondi për të Drejtën Humanitare
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit



Autorë:
Kreshnik Gashi
Iliria Kajdomqaj

Metodologjia e hulumtimit:
Kreshnik Gashi

Hulumtues:
Behar Mustafa
Medianë Halili
Valon Fana
Shkodrane Dakaj

Redaktorë:
Jeta Xharra
Përparim Isufi

Lektor:
Përparim Isufi

Projekti "Ballafaqimi me trashëgiminë e konfliktit në Kosovë" financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e BIRN Kosova.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTVE	5
METODOLOGJIA	8
PËRMBAJTJA E LIMITUAR E INSTITUCIONEVE	9
PUBLIKIMET ME KARAKTER MONO-ETNIK NGA INSTITUCIONET	11
ZERO TË DHËNA NGA INSTITUCIONET	15
E DREJTËSISË	15
SFIDAT NË PUBLIKIMET SHKENCORE	18
PËRMBAJTJA MONO-ETNIKE	20
NË MONUMENTE DHE MUZE	20
NARRATIVAT NË INSTITUCIONET LOKALE	23
Komuna e Prishtinës	23
Komuna e Pejës	24
Komuna e Gjilanit	25
Komuna e Gjakovës	26
Komuna e Graçanicës	27
Komuna e Rahovecit	27
NARRATIVI I TRANSMETUAR NË MEDIA	29
RRËFIMET PËR SOLIDARITETIN	31
MES KOMUNITETEVE	31
REKOMANDIME	33



IN UNITY WE PROSPER

PËRMBLEDHJE EKZEKUTVE

Diskursi publik në Kosovë vazhdon të jetë i dominuar nga tema që lidhen me krimet e luftës dhe ngjarjet në mes viteve 1998-2000.

Të dhënat tregojnë se një numër i konsiderueshëm i lajmeve të publikuara nga Institucionet e Kosovës gjatë vitit 2023 ishin me këtë temë ndërsa në datat e monitoruara mediumet kryesore në vend i patën temë kyçe ngjarjet për luftën dhe përkujtimet për to.

Fushata e fundit për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 kishte temë bosht marrëdhëniet me Serbinë, hetimet për krimet e luftës, të zhdukurit me dhunë, kompensimin e dëmeve dhe trajtimin e kategorive të konfliktit.

Shumica e partive politike përfshirë koalicionin aktual qeverisës u zotuan të ndërtojnë mekanizma të ndjekjes penale dhe mekanizma për kompensimin e viktimave të konfliktit gjatë mandatit të ri qeverisës.

Në planet e partive politike por edhe në diskursin publik një vëmendje e veçantë iu dha investimeve që duhet t'i realizojnë autoritetet në hetimin dhe dokumentimin e së kaluarës.

Për dallim nga autoritetet, institucionet e drejtësisë të cilat kanë një rol kyç në realizimin e qëllimeve të drejtësisë tranzicionale ishin skajshmërisht jo aktive në informimin e publikut për temat që lidhen me konfliktin dhe drejtësinë tranzicionale.

Brenda vitit 2023 dhe muajve të parë të vitit 2024, BIRN analizoi publikimet e institucioneve publike në Kosovë për të kuptuar nëse këto publikime kishin zbatuar parimet e drejtësisë tranzicionale, ishin gjithëpërfshirëse dhe nuk transmetonin narrativë mono-etnike.

BIRN ka gjetur se institucionet e Kosovës vazhdojnë të kenë limite të theksuara në hetim dhe dokumentim të së kaluarës.

Gjykimi dhe ndjekja penale e krimeve të luftës është njëra nga shtyllat kryesore të drejtësisë tranzicionale¹. Prokuroria Speciale ka një ekip prej 4² prokurorësh ndërsa në Policinë e Kosovës janë më pak se 40 policë që hetojnë krimet e luftës.

Ky numër është vlerësuar në vazhdimësi si i ulët dhe joadekuat për të dokumentuar krimet e luftës në vend dhe për të siguruar ndëshkueshmërinë e krimeve të luftës³.

Institucionet e drejtësisë nuk kanë bërë asnjë hap për ta njoftuar publikun për gjykimet dhe hetimet e krimeve të luftës dhe për të ndërtuar arkiva të cilat dokumentojnë këto procese gjyqësore.

BIRN ka gjetur se KGJK dhe PK nuk kanë ndërtuar platforma ku arkivohen rastet dhe ofrohen të dhëna për krimet e luftës. Madje në faqet e këtyre institucioneve nuk gjenden as të dhënat për gjykimet e UNMIK e EULEX të cilat janë zhvilluar në Kosovë e as të dhëna për gjykimet në TPNJ në Hagë.

Për këtë arsye edhe burimi kryesor i të dhënave për mediat vazhdojnë të mbesin politikanët të cilët nuk ofrojnë informacione të plota për proceset gjyqësore dhe ngjarjet që kanë ndodhur gjatë konfliktit sidomos të dhëna të plota për viktimat.

¹ Drejtësia kriminale/penale, Qendra ndërkombëtare për drejtësi tranzicionale, <https://www.ictj.org/criminal-justice>

² Faqja zyrtare e Prokurorisë së Shtetit <https://prokuroria-rks.org/psh/prokuroria-speciale/401/departamenti-pr-krime-lufte>

³ Më shumë se gjysma e hetuesve të rinj për krime të luftës janë pa përvojë në hetime, Kallxo.com, 2023, <https://kallxo.com/gjate/me-shume-se-gjysma-e-hetuesve-te-rinj-per-krime-te-lufte-jane-pa-pervojene-hetime/>

Në fushën kërkimore shkencore, vendi nuk ka publikime serioze të realizuara nga universitetet dhe Akademia e Shkencave që adresojnë temën e drejtësisë tranzicionale⁴.

Autoritetet e Kosovës së fundmi themeluan Institutin për krimet e luftës të quajtur 'Institutin për Krimet e Kryera Gjatë Luftës në Kosovë'⁵. Ky mekanizëm pritet të funksionalizohet plotësisht në vitet në vijim.

Në mungesë të një pune serioze të dokumentimit, Kosova ka probleme të theksuara në të dhënat për të kaluarën sidomos me të dhëna të sakta për viktimat dhe llogaritjen e dëmeve të konfliktit.

Institucionet e Kosovës nuk kanë një listë zyrtare të konfirmuar me numrin e viktimave të konfliktit së fundit. Mungesa e listës zyrtare ka krijuar konfuzitet në terren ku një pjesë e viktimave të konfliktit kanë marrë epitete të dëshmorëve apo ish-ushtarëve të UÇK-së pa qenë të tillë. Ngjashëm, disa prej viktimave civile serbe portretizohen si ish-pjestarë të policisë dhe forcave paraushtarake.

E vetmja listë e konfirmuar është lista e personave të zhdukur me forcë e cila është e dakorduar në mes qeverisë së Serbisë dhe autoriteteve të Kosovës. Listat dhe shifrat zyrtare të viktimave civile përfshirë të vrarët e të plagosurit, viktimat e dhunës seksuale, njerëzit me trauma psikologjike si pasojë e konfliktit mungojnë dhe së bashku me to mungojnë edhe listat e pjesëtarëve të uniformuar të vrarë e të plagosur.

I vetmi burim relevant i informacionit për numrin e viktimave dhe dëmeve në vend është Fondi për të Drejtën Humanitare. Sipas FDH⁶, nga 13 mijë e 535 viktimat e konfliktit, shqiptarët e Kosovës përbëjnë numrin më të madh të viktimave me 10.812, serbët e Kosovës me 2.197 viktima, kurse romët e Kosovës, boshnjakët e Kosovës, malazezët dhe komunitetet tjera përbëjnë 526 viktima. BIRN ka konstatuar probleme serioze në përdorimin dhe interpretimin e të dhënave për viktimat.

Në shumicën e rasteve të analizuara, materialet e publikuara në ueb faqe, në platforma të rrjeteve sociale apo gjatë fjalimeve të politikanëve, përmenden vetëm viktima të një etnie. Në këtë frymë, në postimet publike të liderëve politikë mungon përkujtimi për viktimat e etnive të tjera.

Të dhënat e grumbulluara tregojnë se vetëm një numër i vogël i monumenteve siç janë ai i Bllacës, Memoriali Heroinat dhe Obelisku për të pagjeturit paraqesin viktimat e të gjitha komuniteteve. Monumentet e tjera janë mono-etnike dhe paraqesin vetëm viktimat e një etnie.

Hulumtuesit kanë gjetur raste si ai i fshatit Potërç i Epërm⁷ në Pejë, ku më 29 mars 1999 u vranë 15 persona. Tre nga të vrarët ishin nga komuniteti ashkali ndërsa të tjerët ishin shqiptarë të Kosovës. BIRN gjeti se viktimat nga komuniteti ashkali nuk janë varrosur në kompleksin e dëshmorëve por në varrezat e fshatit.

Në mungesë të të dhënave të sakta, edhe 25 vjet pas konfliktit informacionet të cilat publikohen në media janë të paplota dhe nuk pasqyrojnë në tërësi konfliktin dhe ngjarjet pasuese me gjithë pasojat e saj.

Në raportimet e analizuara të medias së një etnie, nuk janë gjetur asnjëherë të dhëna për viktimat e etnive të tjera të konfliktit.

⁴ Përgjigje nga Akademia e Shkencave.

⁵ Ligji Nr. 08/L-177 Për institutin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë, 2023, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=79157>

⁶ Libër kujtimi për Kosovën, Fondi për të drejtën humanitare (FDH), http://www.kosovskaknjigapamcenja.org/?page_id=29&lang=de

⁷ Vizitë në terren nga hulumtuesit e projektit, 2024

Në monitorimin e mediave vërehet shmangie serioze e të dhënave për gjykimet në Tribunalin e Hagës. Mungon konstatimi sidomos se kush është dënuar për krimet e luftës në Kosovë.

Përkundër sfidave dhe problemeve në terren, hulumtesit kanë vërejtur se në pjesën më të madhe të diskursit publik të politikanëve shqiptarë të Kosovës ka pasur avancim të madh në shmangien e gjuhës përgjithësuese dhe gjuhës së fajësimit kolektiv të etnive.

Në mediat dhe profilet e politikanëve të analizuar për qëllim të këtij hulumtimi, narrativa fajësuese për krimet në Kosovë është atribuar në “regjimin serb” apo në “regjimin e Millosheviçit” duke shmangur fajësimin kolektiv të popullit serb. Kjo gjuhë tregon për një vullnet të mirë për të bërë hapa pozitivë drejt përmbushjes së standardeve të drejtësisë, respektimit të parimeve të ballafaqimit me të kaluarën si dhe shmangjes së diskursit të fajësimit kolektiv. Por, hulumtimi zbulon se në vazhdimësi narrativa vazhdon të promovojë vetëm fajësimin si koncept ndërsa nuk janë hasur raste të promovimit të historive të solidaritetit dhe ndihmës mes komuniteteve. Hulumtuesit takuan mbi 30⁸ persona të cilët kujtojnë ngjarje të solidaritetit, gjatë konfliktit, në mes komuniteteve mirëpo vetën një numër i vogël i tyre pranuan t’i ndajnë me publikun historitë, përjetimet dhe përvojat e tyre gjatë konfliktit. Historitë e tyre konsistojnë kryesisht në tregime për ruajtjen e shtëpive, sigurimin e ushqimit dhe ndarjen e informacioneve për sulmet që do të ndodhnin.

⁸ Takimet e ndryshme në terren u realizuan nga hulumtuesit e projektit, 2024

METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij hulumtimi është identifikimi i informacioneve për ngjarjet e konfliktit, të paraqitura në monumente, dokumente zyrtare dhe diskursin publik të ndërtuar nga institucionet, politikanët dhe mediat gjatë vitit 2023-2024.

Ky raport paraqet të dhëna të grumbulluara gjatë periudhës tetor 2023 - mars 2024 nga intervistat, vizitat në terren dhe monitorimi direkt i mediave dhe publikimeve në rrjetet sociale të mbi 50 burimeve të informacionit.

Synimet e hulumtimit ishin të kuptohej nëse:

- platformat publike online paraqesin narrativë të solidaritetit;
- përmbajtja në platformat publike online respekton parimet e ballafaqimit me të kaluarën dhe drejtësinë tranzicionale;
- politikanët kanë shpërndarë narrativë që përkon me parimet e ballafaqimit me të kaluarën dhe drejtësinë tranzicionale;
- monumentet e kujtesës dhe memorializimit si dhe mbishkrimet përkujtimore paraqesin historinë e plotë të ngjarjes dhe nëse institucionet publike kanë financuar apo mbështetur nisma që promovojnë drejtësinë tranzicionale;
- mediat kanë arritur të publikojnë informacione që tregojnë historinë e plotë të ngjarjeve;
- mediat kanë publikuar storie të solidaritetit; dhe
- mediat nuk kanë shpërndarë materiale mbi fajësim kolektiv

Për të zhvilluar një hulumtim sa më gjithpërfshirës, BIRN Kosova ka përcaktuar edhe mostrat e matjes. Në përmbajtjen e publikuar gjatë vitit 2023 hulumtuesit kanë analizuar të dhëna në faqet zyrtare të institucioneve dhe profilet në rrjetet sociale të institucioneve si :

- Autoritetet e Kosovës
- Presidenca e Kosovës
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
- Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës
- Instituti i Historisë
- Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- Prokuroria e Shtetit
- Komunitatet e targetuara (Rahovec, Gjakovë, Prishtinë, Graçanicë, Pejë dhe Gjiçan)

Me qëllim të matjes së narrativës së shpërndarë në media, BIRN Kosova ka monitoruar publikimet nga 10 media kosovare përfshirë 5 kanale televizive dhe 5 media online për të analizuar mënyrën e raportimit në dy data të caktuara: 15 janarin, datën kur ndodhi Masakra e Reçakut dhe 24 marsin ditën kur nisën bombardimet e NATO-s mbi ish-Jugosllavinë.

Monitorimi ka përfshirë:

- 7 media në gjuhën shqipe
- 2 media në gjuhën serbe
- 1 media nga komunitetet tjera jo-shumicë

PËRMBAJTJA E LIMITUAR E INSTITUCIONEVE

Institucionet e Kosovës në publikimet e tyre në faqet zyrtare nuk kanë një platformë të dedikuar dhe një përmbajtje të strukturuar e cila i ofron publikut të dhënat e plota për ngjarjet e konfliktit dhe drejtësinë tranzicionale.

Pasi u analizua përmbajtja online e 16 institucioneve BIRN Kosova konstatoi se informacionet janë të mangëta dhe nuk ofrojnë tregimin e plotë.

Institucionet e përfshira në hulumtim në publikimet e tyre nuk kanë përdorur të dhënat e TPNJ, të dhënat nga sistemi gjyqësor i UNMIK-ut, të dhënat e EULEX e as të gjykatave vendore në publikimet që lidhen me konfliktin dhe drejtësinë tranzicionale.

Sfida tjetër është se institucionet nuk kanë publikuar as të dhënat bazike statistikore mbi ngjarjet e konfliktit përfshirë numrin e viktimave dhe dëmet e regjistruara të luftës. Në regjistrimin e fundit të popullsisë i cili është mbajtur në vitin 2024 ASK⁹ ka nisur të grumbulloj të dhëna për dëmet e deklaruar të luftës nga qytetarët. Bashkë me këtë listë mungojnë edhe të dhëna të sakta dhe përcaktime të sakta për kategorizimet e viktimave nga institucionet dhe narrativa se ku dhe kush i ka kryer krimet.

Në adresat e institucioneve të monitoruara, pjesa më e madhe e informacioneve për konfliktin ofrohen në formë të lajmeve të cilat gjatë publikimit kanë mungesë të theksuar të informacioneve përfshirë kohën e nisjes së konfliktit, numrin e viktimave, etninë e viktimave të konfliktit dhe përgjegjësit e dënuar deri më tani.

Sfidë tjetër e identifikuar është mungesa e ndërlidhjes së lajmeve me adresat ku ndodhen të dhënat bazike si lista e personave të zhdukur, baza ligjore që rregullon çështjen e viktimave madje lajmet nuk kanë ndërlidhje me adresat institucionale të dedikuara për promovimin e drejtësisë tranzicionale.

Nr.	Institucioni	Hapësirë të dedikuar për të dhënat nga ngjarjet e konfliktit
1	Presidenca e Kosovës	Nuk ka
2	Zyra e Kryeministrit	Nuk ka
3	Ministria e Drejtësisë	Nuk ka
4	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	Nuk ka
5	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Nuk ka
6	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Nuk ka
7	Prokuroria e Shtetit	Nuk ka
8	Agjencia për Mbrojtjen e Monumenteve dhe Kompleksve Memoriale	Nuk ka
9	Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës	Nuk ka
10	Instituti i Historisë	Nuk ka
11	Komuna e Prishtinës	Nuk ka
12	Komuna e Pejës	Nuk ka
13	Komuna e Gjakovës	Nuk ka
14	Komuna e Rahovecit	Nuk ka

⁹ Regjistrimi i popullsisë, 2024, <https://ask.rks-gov.net/Rekos>



15	Komuna e Graçanicës	Nuk ka
16	Komuna e Gjilanit	Nuk ka

Grafiku 1: Hapësira e dedikuar për të dhënat që lidhen me konfliktin

Tabela e mësipërme tregon se institucionet e sipërpërmendura nuk kanë një hapësirë të veçantë të ndarë brenda ueb faqeve ku janë publikuar të gjitha informacionet për luftën dhe ngjarjet pasuese.

BIRN Kosova konstatoi se në këto adresa ka disa materiale të shpërndara në formë lajmesh dhe vështirë të navigueshme për publikun.

PUBLIKIMET ME KARAKTER MONO-ETNIK NGA INSTITUCIONET

Përpos analizimit të përmbajtjes online të arkivuar në institucione adresave, BIRN Kosova analizoi edhe përmbajtjen e informacionit të shpërndarë nga institucionet në rrjete sociale dhe në faqet e lajmeve.

BIRN Kosova konstatoi se institucionet qeveritare të përfshira në hulumtim në platformat e tyre zyrtare publikojnë numër të konsiderueshëm të lajmeve për ngjarjet që lidhen me konfliktin dhe drejtësinë tranzicionale.


Por të dhënat tregojnë se krerët e institucioneve publike në publikimet online nuk kanë përkujtuar viktimat e të gjitha etnive në Kosovë duke krijuar një trend që drejtuesit shqiptarë të institucioneve përkujtojnë vetëm viktimat shqiptare ndërsa ata serbë (Komuna e Graçanicës) vetëm viktimat serbe.

Numri	Institucioni	Publikime të ndërlidhura me konfliktin	Publikime të ndërlidhura me etnitë tjera gjatë konfliktit	Publikime në total
1	Presidenca	64	0	660
2	Autoritetet	69	0	1156
3	Ministria e Drejtësisë	6	0	206
4	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	3	0	185
5	ASHAK	4	0	67
6	AMMKM	23	0	51
7	KGJK	1	0	246
8	Prokurori i Shtetit	21	0	246
9	Komuna e Prishtinës	3	0	175
10	Komuna e Pejës	3	0	298
11	Komuna e Gjakovës	14	0	246
12	Komuna e Gjilanit	21	0	252
13	Komuna e Graçanicës	1	0	211
14	Komuna e Rahovecit	44	0	558
15	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	16	0	508
16	Instituti i Historisë	26	0	300

Grafiku 2: Lajmet e publikuara në total nga institucionet e ndryshme

Në 16 institucione janë analizuar 5,365 lajme të publikuara prej të cilave është konstatuar se 320 kanë qenë lajme që ndërlidhen me drejtësinë tranzicionale.

Në diagramin si më poshtë, të shpërndara theksohen publikimet e tërësishme të institucioneve individuale krahas të dhënave që janë me interes të hulumtimit. Marrë në përgjithësi, interesimi institucional rreth temës hulumtuese është 5.9 %. Pjesa më e madhe e këtyre publikimeve kanë kujtuar vetëm viktima të një etnie ndërsa mungojnë të dhënat bazike për ngjarjet e konfliktit.




Grafiku 3: Lajmet e publikuara të ndërlidhura me konfliktin

Në faqen zyrtare të kryeministrit¹⁰ afër 5.6% e lajmeve lidhen me këtë temë.

Përgjatë vitit 2023 në ueb-faqe e kryeministrit janë publikuar **1156** lajme, nga të cilat **69** lajme apo 5.6% nga tërësia janë lajme që janë të ndërlidhura me konfliktin, drejtësinë tranzicionale, paqen, ballafaqimin me të kaluarën, kujtesën kolektive e memorializimin.

¹⁰ Ueb-faqja e Zyres së Kryeministrit të Kosovës, <https://kryeministri.rks-gov.net/lajme/>



Grafiku 4: Kategorizimi i lajmeve të publikuara nga kryeministri

Ajo çfarë është në interes të këtij hulumtimi janë 69 lajmet e publikuara nga autoritetet, nga të cilat 47.8% e publikimeve janë pjesëmarrjet dhe nderimet e Kryeministrit në përkujtimin e masakrave ndaj shqiptarëve të Kosovës si dhe në përkujtim të dëshmorëve të UÇK-së.

Në të gjitha lajmet e publikuara, komuniteti serb i Kosovës përmendet **vetëm dy herë** dhe atë në rastin e parë në takimin apo pritjen që Kryeministri Kurti e bëri për Nikola Sanduloviq¹¹ - Kryetar i Partisë Republikane në Serbi, në zyrën e tij dhe në rastin tjetër në vizitën që ai kishte realizuar te dy familje të komunitetit serb¹² me rastin e përfitimit të subvencioneve për fermerë nga ministria e linjës.

Në këtë analizim të publikimeve të lajmeve tek ueb-faqja e kryeministrit janë hasur **zero storie të solidaritetit** mes komuniteteve që jetojnë në Kosovë dhe **zero storie që tregojnë solidaritet** mes komunitetesh në kohën e konfliktit në Kosovë.

Sasia e informacioneve për konfliktin është më e lartë në postimet e kryeministrit në rrjetet sociale. Gjatë periudhës janar - dhjetor 2023, Kryeministri ka realizuar 207 postime në rrjetin social Facebook, mes të cilave 38 postime janë për ngjarjet e luftës. Në asnjërin prej tyre nuk janë përmendur të gjitha viktimat e të gjitha etnive. Kryeministri ka shkruar më pak në rrjetin social 'X' (ish-Twitter). Sipas të dhënave, nga 530 cicërima gjatë vitit 2023, vetëm 9 ishin për luftën¹³.

Në profilin zyrtar të kryeministrit Kurti, në asnjë prej publikimeve nuk promovohet ndonjë storie solidariteti mes komunitetesh, që tregon për ndihmën, mbrojtjen apo

¹¹ Kryeministri Kurti pret kandidatin për President të Serbisë, Nikola Sanduloviq, 2023, <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/kryeministri-kurti-pret-ne-takim-kandidatin-per-president-te-serbise-nikola-sanduloviq/>

¹² Kryeministri Kurti viziton familjet Miletiq dhe Komatoviq nga Komuna e Istogut, 2023, <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/kryeministri-kurti-viziton-familjet-miletiq-dhe-komatoviq-nga-komuna-e-istogut/>


¹³ Të dhëna të mbledhura nga monitorimi i profilit në rrjetin social X të Albin Kurtit, 2023, <https://rb.gy/61sp8g>

bashkëpunimin mes civilëve të paarmatosur nga komunitete të ndryshme, të gjendur mes luftimeve dhe zonave të konfliktit ashtu siç edhe pas mbarimit të saj, në rimbëmbjen shoqërore që do të pasonte. Ngjashëm me ueb-faqen e Kryeministrit, edhe faqja e Presidencës¹⁴ nuk ka një ndarje të qartë të narrativës për konfliktin dhe kjo mbulohet vetëm me lajme dhe komunikata.

Në ueb-faqen e Presidentes së Republikës së Kosovës për vitin 2023 janë publikuar 660 lajme prej të cilave 64 lajme të publikuara ndërlidhen me çështjen e drejtësisë tranzicionale, ballafaqimit me të kaluarën, konfliktin në Kosovë pra, në përqindje 8.8% të të gjitha lajmeve.

Nga 64 lajme apo 8.8% e të lajmeve të publikuara, 46.9% janë përkujtim i masakrave ndaj civilëve shqiptarë të Kosovës. Në asnjë rast të vetëm kur përkujtohen viktimat, nuk ka ndonjë krim a vrasje që përkujton viktimat jo-shqiptare të Kosovës në luftë. 26.6% e këtyre lajmeve janë përkujtim dëshmorësh, akademi përkujtimore për dëshmorë e heronjë, data të lindjes e data të rënies së tyre.

Në publikimet e Presidencës, është hasur vetëm një storie solidariteti në komunitet dhe atë në fshatin Zllakuqan të komunës së Klinës, të cilët në kohën e konfliktit ndihmuan refugjatët nga Mitrovica, mirëpo kjo është një storie ku shqiptarët u ndihmuan shqiptarëve.



Grafiku 5:Kategorizimi i lajmeve të publikuara nga Presidentja

Në rrjetet sociale si 'X', Presidentja ka bërë disa postime për çështjen e viktimave të konfliktit mirëpo në asnjërën prej tyre nuk janë hasur storie të solidaritetit.

¹⁴ Ueb-faqja e Presidentes Vjosa Osmani, 2024, <https://president-ksgov.net/>

ZERO TË DHËNA NGA INSTITUCIONET E DREJTËSISË

Njëra ndër shtyllat kryesore të drejtësisë tranzicionale është ndjekja penale, rrjedhimisht ndëshkueshmëria dhe informimi i publikut për ndëshkimin e krimeve të luftës.

Ministria e Drejtësisë ka në kompetencë Departamentin për Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimin ndërsa Këshilli Prokurorial i Kosovës ka Prokurorinë e Shtetit përderisa Këshilli Gjyqësorë i Kosovës ka gjykatat.

BIRN ka konstatuar se PK dhe KGJK¹⁵ kanë dështuar të ndërtojnë platforma të veçanta ku ofrojnë të dhëna për procesin e hetimit dhe ndëshkimit të krimeve të luftës. Këto institucione nuk kanë arritur të krijojnë as arkivë digjitale për rrjedhën e proceseve gjyqësore të cilat lidhen me drejtësinë tranzicionale.

Hulumtuesit konstatuan se në platformat e menaxhuara nga KGJK nuk ka një ndarje e cila bën publike të dhënat dhe historikun e proceseve të krimeve të luftës në Kosovë. Në këto platforma nuk ka procesverbale të proceseve e as materiale të arkivuara në video për proceset gjyqësore të krimeve të luftës.

Madje në faqen zyrtare të KGJK-së nuk janë bartur as informacionet e proceseve gjyqësore të cilat janë realizuar nga gjykatësit e UNMIK-ut dhe gjykatësit e EULEX-it.


Situata është e ngjashme edhe në faqet zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe në Prokurorinë e Shtetit. Në faqen e Prokurorisë së Shtetit nuk ka materiale që ofrojnë të dhëna për të kaluarën dhe proceset që lidhen me drejtësinë tranzicionale. Të dhënat e vetme janë lajmet për aktakuzat dhe strategjia për hetimin e krimeve të luftës të cilat janë të pamjaftueshme për publikun dhe nuk ofrojnë as të dhënat bazike për proceset që janë duke u zhvilluar. Ngjashëm me KGJK-në edhe PSH nuk ka ndërtuar platformë të dedikuara për krimet e luftës ashtu siç e ka TPNJ, Dhomat e Specializuara në Hagë apo edhe Prokuroria e Posaçme e Serbisë për krimet e luftës. Të vetmet informacione që i ka publikuar Prokuroria e Shtetit gjatë kësaj kohe janë lajmet për aktakuzat të cilat janë gjysmake dhe nuk ofrojnë historik për ngjarjet.

Brenda faqeve të KGJK-së dhe PSH-së nuk ka asnjë aktakuzë për krime të luftës të redaktuar e të publikuar, standard ky që është përdorur në tribunalet ndërkombëtare por edhe nga Dhomat e Specializuara.

Në interes të këtij hulumtimi, BIRN Kosova ka analizuar përmbajtjen e materialeve të publikuara nga prokuroria gjatë 2023. Aty konstatohet se janë 21 lajme që ndërlidhen me temën e hulumtimit, pra janë 21 lajme që flasin për krime të luftës. Nga këto lajme, 76.2% janë lajme që kanë të bëjnë me ngritjen e aktakuzave për krime lufte kundër popullatës civile ndërsa 14.3% kanë të bëjnë me çështjen e dhunimeve seksuale gjatë konfliktit, 4.8% për çështjen e personave të pagjetur dhe po aq edhe në çështjen e masakrave të kryera në Kosovë.

Nga aktakuzat për krime lufte të cilat janë analizuar, në vetëm një rast i akuzuari është nga komuniteti rom i Kosovës kurse të tjerët janë të komunitetit serb i Kosovës dhe në shumicën e rasteve me dyshetësi- kosovare dhe serbe.

¹⁵ Monitorimi i ueb-faqeve të PK-së dhe KGJK-së nga hulumtuesit e projektit, 2024




Grafiku 6: Kategorizimi i lajmeve të publikuara nga Prokuroria e Shtetit

Për dallim nga Prokuroria e Shtetit e cila të paktën ofron disa lajme, KGJK nuk ka ofruar informacione as nëpërmjet lajmeve të publikuara. Nga 246 lajme të publikuara përgjatë vitit 2023, KGJK nuk ka publikuar asnjë lajm që ndërlidhet me proceset e kohës së konfliktit, ballafaqimin me të kaluarën apo drejtësinë tranzicionale si dhe kujtesën kolektive.

Shumica e lajmeve që janë publikuar kanë të bëjnë me takime të KGJK-së, me forume ku anëtarët e tij kanë marrë pjesë, takime të Kryesuesit të KGJK-së me palë të ndryshme, njoftime të brendshme teknike, njoftime për publikun lidhur me përmbushje të pozitive të punës, takimet për Kodin Civil, punëtori dhe aktivitete të tjera. Në vetëm një lajm promovohet bashkëjetesa por që në përmbajtje, nuk ka ndonjë përfaqësues të komuniteteve jo-shumicë që janë pjesë e KGJK-së që të ketë marrë pjesë në një forum¹⁶ ku ishte diskutuar lidhur me ndërtimin e mirëbesimit si një angazhim për paqen dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor. Komunikata nuk e sqaron as përmbajtjen e kësaj pjesëmarrjeje¹⁷.

¹⁶<https://www.gjyqesori-rks.org/2023/11/23/kgjk-pjese-e-forumit-te-kombeve-te-bashkuara-per-ndertimin-e-mirebesimit-ne-kosove-te-mbeshtesim-bashkejetesen-per-nje-te-ardhme-me-te-mire/>, KGJK, 2023, së fundi e qasur me 29.05.2024

¹⁷ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 2023, <https://www.gjyqesori-rks.org/2023/11/23/kgjk-pjese-e-forumit-te-kombeve-te-bashkuara-per-ndertimin-e-mirebesimit-ne-kosove-te-mbeshtesim-bashkejetesen-per-nje-te-ardhme-me-te-mire/>



Grafiku 7: Kategorizimi i lajmeve të publikuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Përveç tek institucionet e drejtësisë, të dhënat apo platformat të cilat grumbullojnë materialet për ndëshkueshmërinë e krimeve të luftës mungojnë edhe në faqet tjera të institucioneve qeveritare.

Në faqen e Minisitrisë së Drejtësisë është një hapësirë ku ofrohen të dhënat për Departamentin për Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit¹⁸ por kjo hapësirë nuk ofron asnjë informacion tjetër përveç bazës se pse është themeluar ky departament.

Edhe në faqen e Minisitrisë së Drejtësisë mungojnë publikime dhe informacione për drejtësinë tranzicionale. Të vetmet materiale të qasshme për temën edhe në MD janë formatet e lajmeve. Përgjatë vitit 2023, Ministria e Drejtësisë në ueb-faqen e saj ka publikuar 206 lajme nga të cilat vetëm gjashtë (6) janë janë lajme që ndërlidhen me konfliktin, ballafaqimin me të kaluarën apo drejtësinë tranzicionale, kujtesën kolektive, memorializimin mono-etnik dhe narrativa mono-etnike që përbën vetëm 2.8% të publikimeve.

Në interes të këtij hulumtimi, nga gjashtë lajmet që ndërlidhen me këtë hulumtim, 33.3% janë lajme që kanë të bëjnë me përkujtime të ngjarjeve që lidhen me rezistencën dhe konfliktin, që marrin në konsideratë rezistencën e grave në kohën e para dhe gjatë konfliktit në Kosovë. Viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës përbëjnë poashtu 33.3% e apo dy (2) lajme të publikuara kurse të tjerat përbëjnë lajme për çështjen për të pagjeturve (16.7%) si dhe për 'Rinia dhe Strategjia për drejtësi tranzicionale' (16.7%)¹⁹.

¹⁸ Departamenti për Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit, 2024, <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,162>

¹⁹ Rinia dhe Drejtësia Tranzicionale, 2023, <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15,3075>

SFIDAT NË PUBLIKIMET SHKENCORE

Studimi i aspektit historik dhe publikimet shkencore të shkencave sociale janë përgjegjësi e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës si dhe e Institutit të Historisë.

Gjatë vitit 2023, Instituti i Historisë 'Ali Hadri' në Prishtinë ka publikuar disa botime si dhe ka organizuar disa takime, publikime të botimeve, botime në retrospektivë si dhe konferenca. Në rrjetin social Facebook gjatë vitit 2023 janë bërë rreth 300 postime, prej të cilave një shumicë e tyre janë publikime në retrospektivë të botimeve në kohë të ndryshme të cilat ndahen me audiencën e Institutit në këtë rrjet social. Në interes të hulumtimit janë bërë 26 postime ndër botimet e publikuara në vitin 2023, që ndërlidhen me temën e hulumtimit. Ndër to mund të përmenden:

- "Masakra e forcave serbe në Pastasel të Rahovecit" (31 mars 1999), Prishtinë, Instituti i Historisë, 2023
- "Ushtria Çlirimtare e Kosovës -Zona Operative e Llapit", Skender Zhitia, Instituti i Historisë, 2023

Përveç aktiviteteve përkatëse, publikohen postime lidhur me botime të vjetra, në kohë të ndryshme, që ndërlidhen me konfliktin e fundit në Kosovë. Gjithashtu, janë mbajtur disa konferenca, sesione shkencore, ku të ndërlidhura me temën e hulumtimit mund të përmenden këto organizime me kumtesa përkatëse:

- Konferenca Shkencore Ndërkombëtare: "Roli i grave në jetësimin e shtetit të Kosovës" - Aspekte sociale, kulturore dhe politike nga viti 1980 deri në ditët e sotme si dhe
- Sesioni shkencor "Kosova 15 vjet pavarësi - sfidat dhe shtetndërtimi"

Disa nga kumtesat e prezantuara në këto dy konferenca dhe sesione shkencore:

- "Gratë shqiptare në burgjet jugosllave (1980-1990)" – Prof. Dr. Sabile Keçmezi-Basha
- "Roli i gruas shqiptare në çlirimin e Kosovës" – Dr. Teuta Hadri
- "Gruaja shqiptare simbol i lirisë së Kosovës – Zona Operative e Llapit (1998-1999)" - Prof. Dr. Skender Zhitia
- "Qëndrimi i SHBA-së ndaj Sigurisë Kombëtare të Kosovës: Nga lufta deri te shtetndërtimi" - Prof. ass. dr. Arbër Hadri,
- "Operacioni "Shigjeta" histori e lavdishme e Luftës Çlirimtare 1997-1999" - Prof. dr. Bedri Muhadri,
- "Aspekte të Operacionit Forca Aleate (24 mars - 12 qershor 1999)" - Ass. Miftar Kurti.

Marrë në përgjithësi, aktivitetet dhe botimet që në qendër kanë konfliktin, në parim nuk kanë përçarur solidaritet e narrativë gjithëpërfshirëse, as në ueb faqe e as në rrjetin social Facebook. Për më tepër, është shikuar edhe revista periodike e këtij instituti – Kosova për vitin 2023, revistë që përmban artikuj dhe recensione. Nga artikuj që ndërlidhen me konfliktin, mund të përmenden:

- Qëndrimi dhe kontributi Franko-Gjerman në operacionin "Forca aleate" (24 mars - 20 qershor 1999) Miftar Kurti
- Justifikimi i intervenimit të NATO-s në Kosovë në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare - Hamit Kaba
- "Statusi dhe beneficionet e luftëtarëve të LÇN-së (1941-1945) dhe luftëtarëve të UÇK-së (1998-1999) vështrim krahasimtar" - Albin Halimi, Endrit Sada.

Përgjatë vitit 2023 në ueb-faqen e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës janë publikuar 67 lajme nga të cilat 4 lajme kanë të bëjnë me konfliktin, ballafaqimin me të kaluarën apo drejtësinë tranzicionale, kujtesën kolektive, memorializimin mono-etnik dhe narrativën mono-etnike që përbën 5.6% të publikimeve. Nga këto katër (4) lajme të publikuara, të gjitha (100%) kanë të bëjnë me organizimin e konferencave shkencore dhe botimeve lidhur me, ashtu siç janë publikuar, gjenocidin dhe masakrat e Serbisë në Kosovë²⁰. Duke e parë varfërinë e theksuar në publikime të lajmeve, hulumtuesit kanë analizuar edhe botimet që gjenden në një nga seksionet e kesaj ueb-faqeje. Te seksioni shoqëror dhe ai i botimeve të publikuara për vitin 2023 gjenden katër (4) botime dhe konferenca nga të cilat dy (2) kanë të bëjnë me gjenocidin²¹ e Serbisë në Kosovë.

Në ueb-faqen e këtij institucioni **nuk ka asnjë opsion për përkthim**, pra teknikisht në nuk është ndonjë buton që e bën audiencën jo shqip-folëse të kuptojnë për çfarë është publikuar lajmi. Rrjedhimisht, kjo nënkupton që **nuk ka asnjë** lajm të përkthyer në gjuhët e tjera. Po ashtu **asnjë** nga lajmet e publikuara nuk përçojnë storie solidariteti. Përpos ASHAK-ut janë analizuar edhe publikimet në faqen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. MKRS ofron mbështetje për projekte kulturore të cilat kujtojnë dhe shpërfaqin me aktivitete kulturore të kaluarën.

Në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit hulumtuesit kanë gjetur 16 lajme që lidhen me kategorinë e synuar nga këto lajme. Prej tyre 37.5% janë lajme mbi prodhime artistike që lidhen me konfliktin. Këtu bëjnë pjesë libra, ekspozita si dhe prodhime teatrore e filmike. **16 lajmet e analizuar** që përkojnë me temën e hulumtimit nuk janë të përkthyer në gjuhën serbe. Gjithashtu, në **asnjë (0)** prej lajmeve të publikuara nuk përçojnë ndonjë storie solidariteti të komuniteteve gjatë konfliktit në Kosovë.

²⁰ Publikim rreth botimeve mbi gjenocidin dhe masakrat në Kosovë, 2023, <https://ashak.org/botime/gjenocidi-i-pushtetit-serb-ndaj-shqiptareve-ne-kosove-gjate-viteve-90/>


²¹ ASHAK, Konferenca shkencore: Gjenocidi dhe masakrat e Serbisë në Kosovë (1998-1999), 2023, <https://ashak.org/konferenca-shkencore-gjenocidi-dhe-masakrat-e-serbise-ne-kosove-1998-1999/>

PËRMBAJTJA MONO-ETNIKE NË MONUMENTE DHE MUZE

Në vitin 2013, përmes një ligji²² të veçantë, Kosova ka krijuar një Agjenci për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale. Ky institucion, që funksionon si i pavarur, është përgjegjës për ndërtimin e muzeve, ruajtjen e relikteve dhe ndërtimin e memorialeve për ngjarjet e konfliktit.

Të dhënat zyrtare nga AMMKM tregojnë se kjo agjenci ka të regjistruar në Kosovë rreth 1547²³ monumente, pllaka përkujtimore apo shenja të cilat kujtojnë konfliktin e fundit në Kosovë. Kjo agjenci ka në menaxhim edhe 13 muze të cilët lidhen me konfliktin e fundit. Në tërësinë e monumenteve, muzeve dhe hapësirave memorializuese Agjencia numëron një numër të vogël të monumenteve të cilat kujtojnë vitkimat e të gjitha etnive. AMMKM përmend Memorialin e eksodit ‘Bllaca’ si memorial që i kujton të gjithë të zhvendosurit jashtë Kosovës, Memorialin Heroinat i cili i pasqyron viktimat e dhunës dhe Memorialin e të zhdukurve.²⁴

Përgjatë vitit 2023 në ueb-faqen e Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale janë publikuar 51 lajme nga të cilat 23 lajme janë lajme që ndërlidhen me konfliktin. Nga këto 78.3% janë lajme që lidhen direkt me konfliktin dhe atë me aktivitete përkujtimore për dëshmorët si dhe për projekte që lidhen me konfliktin dhe në veçanti dëshmorët. Nga të gjitha këto lajme, në vetëm tre lajme apo 13% fokusohen masakrat - që i përkasin një etnie, pra në të gjitha këto masakrat përmenden viktimat civile shqiptare të Kosovës. Për më tepër, asnjë lajm nuk është i përkthyer në gjuhën serbe apo gjuhët tjera dhe nuk është hasur ndonjë lajm që kujton solidaritetin mes komuniteteve.



Grafiku 8: Kategoria e lajmeve të publikuara nga AMMKM

²² Ligji Nr. 04/L-146 Për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës

²³ Lista e monumenteve burim Agjencioni për Mbrojtjen e Monumenteve

²⁴ Intervistë Shqipe Zogaj Agjencioni për Mbrojtjen e Monumenteve.

Në terren, hulumtuesit kanë vizituar mbi 20 komplekse përkujtimore për viktimat e konfliktit. Të dhënat tregojnë se pjesa më e madhe e monumenteve janë mono-etnike ndërsa vërehen probleme në emërimin e viktimave. Në disa raste është hasur që viktimat civile janë emëruar si dëshmorë në raste të tjera si martirë në raste të tjera si heronj të Kosovës pa transmetuar një narrativë të njëjtë.

Ekipi hulumtues ka vizituar gjashtë komuna për t'i parë memorialët dhe pllakat përkujtimore mbi luftën e fundit në Kosovë²⁵. Në kompleksin e memorial të varrezave në fshatin Celinë²⁶ të Komunës së Rahovecit ekipi hulumtues ka parë që civilët e vrarë gjatë luftës, si nga shqiptarët dhe nga komuniteti egjiptian janë varrosur në një vend dhe nuk ka pasur ndonjë ndasi. Përveç se janë varrosur në të njëjtin vend ata janë përfshirë edhe pllakën përkujtimore bashkë me martirët e tjerë.

Në varrezat në fshatin Krushë e Madhe të Rahovecit, emrat e civilëve të vrarë dhe të dëshmorëve janë të vendosur në të njëjtën pllakë por në pjesën e emrave të civilëve është vendosur mbishkrimi “Të rënë për lirinë e Atdheut”, ndërsa në pjesën e emrave të dëshmorëve është shkruar “Lavdi Dëshmorëve të Kombit. Lokacioni i kompleksit përkujtimor gjendet afër varrezave të fshatit.

Gjatë monitorimit në komunën e Pejës, është vërejtur një rast ku civilët të cilët janë vrarë gjatë konfliktit janë përshkruar si dëshmorë ndërsa tre civilë të vrarë nga komuniteti ashkali, në fshatin Potërç i Epërm²⁷, në rajonin e Pejës, një fshat mes Klinës dhe Pejës, nuk janë varrosur në të njëjtin vend si të vrarët e tjerë gjatë luftës edhe pse ishin vrarë në të njëjtën ditë.

Në qendër të qytetit të Pejës është memoriali më i madh që përshkruan të rënë të konfliktin e fundit. Por në këtë memorial janë të vendosur vetëm emrat e viktimave nga komuniteti shqiptar i Kosovës.

Në Gjilan, te “Kodra e Dëshmorëve”, është ndërtuar memoriali më i madh së bashku me varreza ku kujtohen vetëm viktimat shqiptare të kësaj komune.

Drejtori i Kulturës në komunën e Gjilanit Kushtrim Zeqiri²⁸ ka konfirmuar se të gjithë personat e përkujtuar në këtë pllakë i përkasin etnisë shqiptare. Në qendër të qytetit të Gjilanit është ndërtuar një skulpturë monumentale në kujtim të grave që kanë kontribuar në shqëri para dhe pas luftës ky monument e cila ka vetëm përshkrimin “Heroina e qytetit”.

Në Gjakovë, hulumtuesit vizituan dy memoriale²⁹ por edhe aty ka vetëm emra të të vrarëve shqiptarë.

Nga monitorimi në terren, në komunën e Graçanicës konstatohet se në qendër të qytetit është i ndërtuar një instalacion arti, obelisk i dedikuar personave të zhdukur me forcë në Kosovë³⁰. Ashtu siç përshkruhet në tabelën informuese, “Missing” i kushtohet serbëve të Kosovës, romëve të Kosovës, goranëve të Kosovës, boshnjakëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës të zhdukur para, gjatë dhe pas siç thuhet konfliktit në vitin 1999. Obelisku është ndërtuar në atë formë i cili përbëhet nga shkronjat “Missing” që do të thotë “Të zhdukurit”. Në obeliskun për të zhdukurit përdoren fjalë duke pretenduar se personat të cilët janë ekspozuar me fotografi janë rrëmbyer nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, duke përdorur termin

²⁵ Vizita në komunat e targetuara: Rahovec, Gjakovë, Prishtinë, Graçanicë, Pejë dhe Gjilan, 2024

²⁶ Vizitë në terren, fshati Celinë, Rahovec, 2024

²⁷ Vizitë në terren, fshati Potërç i Epërm, Pejë, 2024

²⁸ Intervistë me Drejtorin e Kulturës në komunën e Gjilanit Kushtrim Zeqiri

²⁹ Vizitë në terren e hulumtuesve, Gjakovë dhe Çabrat, 2024

³⁰ Vizitë në terren e hulumtuesve, Graçanicë, 2024



“ekstremistët shqiptarë”. Madje, aty pretendohet se personat e zhdukur janë viktimat të “trafikut të organeve”. Përshkrimi për obeliskun është shkruar në tre gjuhë, në gjuhën serbe, angleze dhe shqipe por emrat janë vetëm në gjuhën serbe dhe është e pamundur të kuptohet nëse aty ka viktimat shqiptare.

Në shkollën fillore në Graçanicë “Mbreti Milutin” është e vendosur një pllakë ku janë përkujtuar dy ish-nxënës të shkollës³¹. Përshkrimi i pllakës përkujtimore thotë se dy viktimat, Nikola Petroviq dhe Marija Petroviq janë “Viktima nga agresorët e NATO-s 01.05.1999”.

³¹ Vizitë në terren e hulmtuesve, Graçanicë, 2024

NARRATIVAT NË INSTITUCIONET LOKALE


Komunat e Kosovës në tërësinë e tyre kanë në kompetencë jetën kulturore sportive e poashtu organizimet përkujtimore për pjesën më të madhe të ngjarjeve të konfliktit në vend. BIRN Kosova ka analizuar përmbajtjet e publikuara nga komuna e Prishtinës, Pejës, Gjakovës, Rahovecit, Gracanicës dhe Gjilanit.

Të dhënat nga monitorimi i publikimeve përgjatë një vitit tregojnë se edhe komunat kanë problemet e ngjashme me nivelin qëndror në përmbajtjen e tyre online dhe në publikimet për drejtësinë tranzicionale.

Në të gjitha komunat e monitoruara nuk ka një hapësirë të dedikuar e cila ofron të dhënat kryesore për ngjarjet e konfliktit ndërsa pjesa më e madhe e informacionit ofrohet në formë të lajmeve gjysmake të cilat nuk japin informacionet bazike për numrin e viktimave dhe etninë e tyre.

Komuna e Prishtinës

Përgjatë vitit 2023 në ueb-faqen e Komunës së Prishtinës janë publikuar 175 lajme, nga të cilat vetëm tri (1.7%) janë lajme që kanë të bëjnë apo ndërlidhen me konfliktin, ballafaqimin me të kaluarën apo drejtësinë tranzicionale, kujtesën kolektive, memorializimin dhe narrativën mono-etnike.




Grafiku 9: Kategoria e lajmeve të publikuara nga Komuna e Prishtinës

Publikimet nuk përmbajnë informacione për të gjitha viktimat e konfliktit dhe të njëjtat nuk janë të përkthyer në dy gjuhët zyrtare. Të dhënat tregojnë që edhe në shënimin e Ditës së Pavarësisë komuna përdori edhe flamurin e Shqipërisë. Më 17 shkurt, në dekorimin zyrtar të qytetit, nuk u vunë vetëm flamujt e Kosovës që përfaqësojnë të gjithë etnitë që jetojnë në Kosovë por vetëm çdo i treti flamur i vendosur ishte i Kosovës. Dy flamujt tjerë ishin ai i Shqipërisë dhe i SHBA-ve³².

³² Monitorim në terren i shfaqjes publike të flamujve në Prishtinë, 2024

Komuna e Pejës

Përgjatë vitit 2023 në ueb-faqen e Komunës së Prishtinës janë publikuar 298 lajme nga të cilat vetëm 3 lajme kanë të bëjnë apo ndërlidhen me konfliktin, ballafaqimin me të kaluarën apo drejtësinë tranzicionale, kujtesën kolektive, memorializimin dhe narrativa mono-etnike.




Grafiku 10: Kategoria e lajmeve të publikuara nga Komuna e Pejës

Të gjitha këto lajme kanë të bëjnë me përkujtime të dëshmorëve dhe zbulim të shtatoreve në përkujtim të përvjetorëve të rënies apo në shënim të Ditës së Pavarësisë së Kosovës. Në asnjë publikim përgjatë vitit 2023, Komuna e Pejës³³ nuk ka shtyrë para, promovuar apo publikuar ndonjë storie solidariteti në mes komuniteteve gjatë konfliktit në Kosovë.

³³ Monitorim i ueb-faqes se Komunes së Pejës nga hulumtuesit, 2024

Komuna e Gjilanit

Përgjatë vitit 2023, në ueb-faqen e Komunës së Gjilanit janë publikuar 252 lajme nga të cilat 21 lajme apo 7.7% janë lajme që kanë të bëjnë apo ndërlidhen me konfliktin, ballafaqimin me të kaluarën apo drejtësinë tranzicionale, kujtesën kolektive, memorializimin dhe narrativën mono-etnike.




Grafiku 11: Përqindja e lajmeve të publikuara nga Komuna e Gjilanit

Shumica e 21 lajmeve të publikuara apo 47.6% e tyre lidhen me përkujtime të dëshmorëve apo betejave të UÇK-së përdorim në 19.1% kanë të bëjnë me përdorimin e artit, siç është rasti me Festivalin Flaka e Janarit, me të cilin festival e manifestim, Komuna e Gjilanit kujton guximin dhe sakrificën e heronjve³⁴.

³⁴ 'Flaka e Janarit 2023' - Vlerësohet sakrifica e heronjve gjilanas, Kallxo.com, 2023 <https://kallxo.com/kulture/flaka-e-janarit-2023-vleresohet-sakrifica-e-heronjve-gjilanas/>

Komuna e Gjakovës

Përgjatë vitit 2023 në ueb-faqen e Komunës së Gjakovës janë publikuar 246 lajme nga të cilat 14 lajme apo 5.4% kanë të bëjnë apo ndërlidhen me konfliktin, ballafaqimin me të kaluarën apo drejtësinë tranzicionale, kujtesën kolektive, përkujtimin mono-etnik dhe narrativën mono-etnike.



Grafiku 12: Kategoria e lajmeve të publikuara nga Komuna e Gjakovës

Shumica e 14 lajmeve të publikuara në fokus janë përkujtime të përvjetorëve të dëshmorëve e betejave të UÇK-së në komunën e Gjakovës³⁵. Shumë prej këtyre lajmeve kanë të bëjnë me homazhe dhe më pas edhe akademi përkujtimore ku kanë marrë pjesë udhëheqësit e kësaj komune.


Asnjë nga 246 lajmet e analizuara që i përkasin vitit 2023, nuk përçojnë storie solidariteti në mes komunitetesh gjatë konfliktit.

³⁵ Monitorim i ueb-faqes së Komunës së Gjakovës, 2024

Komuna e Graçanicës

Në vitin 2023 në ueb-faqen e Komunën e Graçanicës janë publikuar 212 lajme nga të cilat asnjë lajm nuk ka të bëjë apo ndërlidhet me konfliktin, ballafaqimin me të kaluarën, drejtësinë tranzicionale, kujtesën kolektive, memorializimin apo narrativën mono-etnike³⁶.

Në ueb-faqen e komunës së Graçanicës, në fillim të vitit 2024, janë publikuar një grup lajmesh që kanë të bëjnë me fundin e vitit 2023, e që përshkruajnë kryesisht shpërndarjen e pakove ushqimore, stufave si dhe derivateve për ngrohje dimërore dhe marrë në përgjithësi lajmet që janë publikuar kanë të bëjnë me aktivitete komunale, sportive, kulturore si dhe nuk përçojnë storie solidariteti ndëretnik.




Grafiku 13: Kategoria e lajmeve që janë publikuar nga Komuna e Graçanicës

Komuna e Rahovecit

Komuna e Rahovecit në rrjetin e saj social Facebook ka publikuar 558 postime³⁷. 44 nga postimet e shpërndara në Facebook ndërlidhen me temën e hulumtimit. Publikimet janë bërë kryesisht për të përkujtuar beteja, përvjetorë dëshmorësh dhe përkujtime që lidhen me luftën, duke kujtuar kështu vetëm shqiptarët dhe duke mos përçarur asnjë storie solidariteti në mes të komuniteteve përgjatë konfliktit të fundit në Kosovë.

³⁶ Monitorim i ueb-faqes së Komunës së Graçanicës, 2024

³⁷ Ueb-faqja e Komunës në seksionin e lajmeve edhe pas shumë përpjekjeve të evidentuara ka qenë e paqasshme, për këtë arsye si burim i mbledhjes të së dhënave është marrë Facebook-u



Grafiku 14: Kategoria e lajmeve të publikuara nga Komuna e Rahovecit

NARRATIVI I TRANSMETUAR NË MEDIA

Skena mediale në Kosovë në mediat në gjuhën shqipe dhe ato serbe kategorizohet me transmetim të narrativës ashtu siç ofrohet nga politikanët dhe burimet e informacionit.

Si rrjedhojë pjesa më e madhe e informacioneve të transmetuara në media bazohen në të dhënat nga qeveria, institucionet dhe politikanët duke anashkalluar të dhënat të cilat mund të sigurohen nga dokumentet gjyqësore dhe nga prokuroria.

BIRN Kosova monitoroi narrativën e cila u transmetua në media gjatë përkujtimeve në dy data: e para për Masakrën e Reçakut dhe e dyta për përvjetorin e bombardimeve të NATO-s³⁸. Të dhënat tregojnë që informacionet të cilat u transmetuan në këto dy data ishin gjysmake dhe nuk ofronin ngjarjet në tërësinë e tyre.

Në të gjitha raportimet u shmangën të dhënat nga Tribunali i Hagës dhe konstatimet nga kjo gjykatë për përgjegjësit e krimeve të kryera në Kosovë.

Narrativa në disa prej rasteve konstatoi se për krimet nuk ka persona të dënuar edhe përkundër faktit se TPNJ ka shpallur përgjegjës drejtuesit e lartë politikë dhe të zinxhirit komandues të operacionit.³⁹

Në përkujtimet për bombardimet e NATO-s nuk pati një shpjegim të qartë për arsyeshmërinë e bombardimeve dhe misionin të cilin e nisi NATO në Kosovë.

Të dhënat nga monitorimi i mediave online dhe kanaleve televizive tregojnë se në këto dy data një përqindje e lartë e përmbajtjes mbulohej nga raportimet për konfliktin. Për shembull, në portalet online mbi 10% e lajmeve iu dedikuan përkujtimeve për ngjarjet ndërsa në TV në pikun e shikueshmërisë lajmi i parë ishte përvjetori i masakrës dhe përvjetori i bombardimeve⁴⁰.

Në monitorimin e mediave online u hasën gabime faktike dhe gabime në të dhëna. Raportimet e mediave online ishin të shkurta dhe nuk ofronin as informacionet bazike për numrin e viktimave në Reçak, personat përgjegjës për krimin dhe faktet e tjera për masakrën.

Probleme hasen edhe në raportimet në televizione ku qytetarëve nuk u ofrohen të dhënat e plota për Masakrën e Reçakut dhe ofrohen konstatime se asnjë person nuk është dënuar për krimet në Kosovë. Raportimet kanë mungesa të të dhënave të tjera gjenerale për krimet dhe viktimat civile në Kosovë ndërsa në asnjërin prej rasteve të monitoruara nuk u gjetën informacione për viktimat e etnive të tjera.

Në monitorimin e datës 24 mars përpos mungesës së informacioneve për viktimat vërehen edhe probleme të tjera. Në disa raste në portale është hasur togfjalëshi “bombardim ndaj caqeve serbe” pa saktësuar që caqet e NATO-s ishin vetëm caqe ushtarake dhe policore si dhe infrastrukturë ushtarake e policore pa pasur cak civilët.

Në pjesën më të madhe të lajmeve është shmangur informacioni që bombardimet ishin realizuar ndaj Jugosllavisë e cila në atë kohë drejtohej nga Slllobodan Millosheviç duke e ngushtuar bombardimin e NATO-s vetëm mbi Serbinë.

Monitorimi ka konstatuar se mediat sërish kanë realizuar raportim mono-etnik dhe nuk kanë raportuar për viktimat e etnive të tjera.

Përpos monitorimit direkt të përmbajtjes së prodhuar, BIRN Kosova ka realizuar pyetësor për mediat e shkruara, radiot dhe televizionet në Kosovë. BIRN Kosova ka kontaktuar

³⁸ Datat e monitoruara nga hulumtuesit janë: Masakra e Reçakut (15 janar 1999) dhe Data e fillimit të bombardimit nga NATO (24 mars 1999)

³⁹ <https://balkaninsight.com/ep-content/uploads/2022/08/Mico-Stanisic-Stojan-Zupljanin.pdf>

⁴⁰ Monitorim i mediave në data të caktuara nga ekipi hulumtues, 2024



me 80 radio dhe kanale televizive të regjistruara në Kosovë dhe 53 media online për të kërkuar nga ta informacione nëse gjatë dy viteve të fundit kanë publikuar storie të cilat transmetojnë materiale të solidaritetit në mes komuniteteve. BIRN ka pranuar 35 përgjigje nga mediat dhe shumica prej tyre kanë treguar se gjatë viteve të fundit nuk kanë transmetuar asnjë storie e cilat tregon për narrativë të solidaritetit mes komunitetesh në Kosovë. Vetëm një medium ka ofruar një rast të tillë ku ka treguar se si një pjesëtar i familjes Jashari, Bekim Jashari, i ka ndërtuar një shtëpi një pjesëtari të komunitetit ashkali më 5 maj 2022. Të gjitha këto media të shkruara, televizione dhe radio, që kanë kthyer përgjigje në pyetësonin e BIRN kanë thënë se gjatë viteve të fundit nuk kanë publikuar as edhe një storje që tregon për narrativen e solidaritet në Kosovë gjatë viteve 1998-1999.

RRËFIMET PËR SOLIDARITETIN MES KOMUNITETEVE

Një pjesë e rëndësishme e këtij punimi ka qenë edhe hulumtimi i rasteve të solidaritetit në Kosovë, mes komunitetesh me theks të veçantë në rrëfime të solidaritetit gjatë konfliktit por edhe menjëherë pas mbarimit të tij. Edhe një çerek shekulli pas përfundimit të luftës, duke ditur faktin që ka pasur solidaritet ku njerëzit kanë ndihmuar njerëzit pa marrë parasysh petkun etnik, ne filluam hulumtimin për këtë proces. Një fakt poashtu që nuk mund të mohohet është edhe gatishmëria për të treguar por jo edhe për ta ndarë rrëfimin si të plotë, pra me emër e mbiemër, kjo nga frika se mund të paragjykohe apo stigmatizohen jo vetëm nga komuniteti etnik të cilit i takojnë por nga të gjitha etnitë pa përjashtim në Kosovë.

Në publikimet e institucioneve nuk janë përmendur situata ku pjesëtarët e një komuniteti kanë ndihmuar komunitetin tjetër në rrezik gjatë konfliktit ndërsa të dhënat për numrin e viktimave nga të gjitha komunitetet mungojnë. Në situata të tilla qytetarët kanë mungesë të theksuar të informacioneve për ngjarjet dhe realitetin që ka ndodhur.

BIRN kontaktoi me rreth 30 qytetarë të nacionaliteteve të ndryshme në Kosovë për të kuptuar historitë personale të tyre me fqinjët e komuniteteve të tjera⁴¹.

Në rrëfimet e njerëzve pati situata ku rrëfihen dyshime se fqinjët kryen krime të luftës por pati edhe rrëfime që tregonin se fqinjët kishin tentuar të ndihmonin njëri-tjetrin gjatë konfliktit.⁴²

O.V., pjesëtar i komunitetit serb nga Prishtina

“Po flasim për vitin 1999, unë kam jetuar në Prishtinë në një bllok që ka pasë 20 apartamente, edhe kur kanë filluar bombardimet, kur ende KFOR-i nuk kishte hyrë në Kosovë, në banesën tonë të gjitha komunitetet kemi dhënë para edhe kemi ndërtuar derën e hyrjes nga hekuri, edhe ajo derë është hapur në varësi se kush ka trokitë në derë. Nëse ka trokitur policia apo ushtria serbe ka dalë dikush nga banorët serbë, edhe askush nuk ka ikur nga banesa gjatë viteve 1998 dhe 1999, por kanë mbetur aty serbët, shqiptarët dhe boshnjakët”

S.M., pjesëtare e komunitetit serb nga Graçanica

“Mes shqiptarëve e serbëve ka pasur ndihma të ndryshme. Ajo që mund ta përmend unë është që ia kemi ruajtur pronat e shtëpitë njëri-tjetrit, dhe kjo ka ndodhur në periudha të ndryshme; njëherë ne atyre e me vonë shqiptarët i kanë ruajtur pronat e shtëpitë tona. Ruajtja e pronës dhe shtëpive nga njëri komunitet për komunitetin tjetër ka filluar nga 1999 dhe vazhdon edhe sot dhe kurrë nuk është bërë problem por problem në disa kohë ka qenë politika dhe ajo e ka krijuar problemin”.

I.Z., pjesëtar i komunitetit shqiptar në Klinë

“Ne me ato familjet e ashkalive kemi kaluar shumë mirë, kurrë problem nuk kemi pasur. Për dy vite, aq sa kemi mundur i kemi ndihmuar njëri-tjetrit dhe nuk i kemi ndarë askund për kurrëgjë. Më 29 mars 1999 këtu janë vrarë 15 banorë, 11 shqiptar dhe 3 ashkali dhe një e kemi dëshmor. Qysh flitet, një ashkali u vra para derës së shtëpisë pasi nuk kishte pranuar ta heqë plisin nga koka, pastaj janë vra edhe dy tjerë, ndërsa shqiptarët gjithsej 11 janë vrarë në një oborr”.

⁴¹ Kontaktimi dhe vizitat në terren u bënë sipas komunave dhe regjioneve të targetuara nga hulumtuesit, 2024

⁴² Personat që kanë rrëfyer historitë e tyre në të cilat tregohen raste të solidaritetit, kanë kërkuar të mos u ekspozohet identiteti i tyre i plotë për arsye që mund të intimidohen nga të tjerët.

H.S., pjesëtare e komunitetit ashkali në fshatin Celinë, Rahovec

“Ne me shqiptarët gjithmonë kemi kalu mirë dekë e dasmë gjithmonë i kemi pasë bashkë, por serbët kanë hy te kunati dhe i kanë thanë pse keni qëndruar ende këtu ju pse s’keni ikur dhe i kanë vra. Serbët i kemi pas më larg në Krushë të Vogël por me ta s’kemi pasë kontakt shumë sepse kanë qenë me larg. Në kohën e luftës edhe këtu në shtëpi por edhe kur kemi dalë që kemi qëndruar në mal, ushqimin e kemi hëngër bashkë me këta fqinjët shqiptarë. Edhe atje në mal, krejtve na kanë shtri përtokë shqiptarë e ashkali kemi mundur me qenë gjithë të ekzekutuar por kur e thirri njëri nga ata policët i tha boll u plotësua numri dhe na kanë lëshuar pastaj”.

S.Q., pjesëtar i komunitetit ashkali nga Gjakova

“Ne kohën e luftës unë kam jetuar në lagjen Ali Pashë Tepelena e njohur përpara edhe si lagjia e Sefës në Gjakovë. Komuniteti jonë ashkali por edhe komuniteti shqiptar në atë lagje e kemi ndihmuar dhe e kemi mbështetur shumë njëri- tjetrin. Marrë parasysh se ndihma nuk ka pasë nga askush nga institucionet, pasi edhe s’ka pasë kush me na ndihmu, kjo e ka rritë edhe me shumë solidaritetin mes familjeve të etnive të ndryshme në lagjen tonë. Po, shumë i kemi ndihmu njëri-tjetrit. Unë dhe familja ime ju kemi ndihmu sepse aty jetojmë bashkë me shqiptarë dikund në atë lagje 70 përqind janë shqiptarë e nja 30 përqind jemi ashkali dhe ju kemi ndihmu edhe na atyre por edhe ata neve”.

D.B., pjesëtar i komunitetit boshnjak nga Peja

“Ne jemi të komunitetit boshnjak dhe kemi jetuar edhe para luftës në Pejë. Jemi larguar nga Peja vetëm në dy javët e fundit të luftës dhe kemi shkuar në Mal të Zi unë dhe fëmijët, por prindërit kanë qëndruar në Pejë gjatë gjithë kohës dhe qysh dihet shitoret kanë qenë të mbyllura dhe njerëzit kanë jetuar duke e ndihmuar njëri- tjetrin. Atë kohë solidariteti ka qenë më i madh se tash. Ne e kemi pasur një depo (shitore) që ka qenë e madhe dikund rreth 17 metra e gjerë dhe rreth 30 metra e gjatë dhe krejt çka ka pas aty i kemi shpërnda me njerëzit e tjerë. Shumica e njerëzve që kanë marrë sende aty kanë qenë shqiptar por ka pasur edhe te komuniteteve të tjera, sepse edhe në lagje kanë jetuar më së shumti shqiptarët”.

M.S., pjesëtar i komunitetit egjiptas nga Peja

“Unë kam qenë përfaqësues i lagjes edhe në kohën e luftës dhe ndihma që i kam shpërnda në lagje krejt kanë qenë prej shqiptarëve. Deri sa ka filluar me pru ndihma KFOR-i ne kemi pasë ndihma prej shqiptarëve. Nuk kemi hjekë keq për kurrigjë as ne as fëmijët, se nuk kemi zgjedhë ne-çka na kanë pru vetëm ju kemi thanë faleminderit. Unë jam egjiptas dhe jetoj ne mesin e shqiptarëve. Të gjithë shqiptarët që kanë ikur me herët nga lufta çelësat e shtëpive i kanë lanë te unë dhe unë i kam ruajtur shtëpitë e tyre deri sa janë kthyer ata në Kosovë. Edhe sot kemi kontakte të mira me fqinjët tanë shqiptarë”.

REKOMANDIME

Bazuar në të dhënat e grumbulluara gjatë hartimit të këtij raporti, BIRN ka nxjerrë rekomandimet e mëposhtme.

Institucionet qendrore duhet që:

- Të nisin punën për të hartuar një bazë të dhënash për viktimat e konfliktit në Kosovë dhe më të dhënat për dëmet e luftës;
- Të rishikojnë të gjithë përmbajtjen online të publikuar në faqet zyrtare për t'u siguruar që ajo përmban të dhëna për të gjitha viktimat e konfliktit në vend;
- Publikimet e reja të ndjekin standardet dhe të përmbajnë të dhëna të plota për viktimat e të gjitha etnive dhe informacionet e plota për ngjarjet e konfliktit dhe muajt e parë të pas-konfliktit, deri në fund të vitit 1999;
- Drejtuesit e institucioneve në publikimet dhe fjalimet e tyre të përmendin të gjitha viktimat civile të konfliktit.

Institucionet lokale duhet që:

- Të rivlerësojnë të gjitha informacionet e publikuara deri më tani që lidhen me drejtësinë tranzicionale dhe në to të përfshihen të dhënat e plota për numrin dhe etninë e viktimave, dëmet dhe të dhënat për proceset gjyqësore të realizuara për këto ngjarje;
- Hapësirat publike të dedikuara për kujtimin e viktimave të luftës si monumente, muze dhe memoriale të rikurohen dhe në hapësirat ku ka dakordim me komunitetet lokale të vendosen emrat e të gjitha viktimave;

Institucionet e drejtësisë duhet që:

- Të krijojnë hapësira të arkivimit online të seancave gjyqësore të krimeve të luftës dhe të paraqitjes së proceseve gjyqësore që lidhen me drejtësinë tranzicionale;
- Të ndjekin së paku standardin e përdorur nga Dhomat e Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës në Hagë për të publikuar informacione mbi rrjedhën procedurale të rasteve të gjykuara të krimeve të luftës;
- Në rastin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës të nisë transmetimin në video të proceseve gjyqësore të lidhura me krimet e luftës, ashtu siç bëjnë Dhomat e Specializuara dhe mbi praktikata e ndjekura nga TPNJ;
- Të rrisin standardin e publicitetit në rastet e krimeve të luftës duke publikuar procesverbalet dhe të dhënat nga proceset e krimeve të luftës;
- Të ndërtojnë baza të dhënash ku do publikohen të dhënat nga proceset e arkivuara të UNMIK-ut dhe EULEX-it të cilat duhet të hapen për publikun;



Institetet hulumtuese duhet që:

- Të përkrahin studime shkencore e profesionale mbi drejtësinë tranzicionale;
- Hulumtimet e bëra në fushën e drejtësisë tranzicionale të jenë gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në fakte;
- Të respektojnë parimet e drejtësisë tranzicionale

Mediat dhe profesionistët e mediave duhet që:

- Të nisin programe të veçanta trajnimi për gazetarët për të përmirësuar cilësinë e raportimit në raport me drejtësinë tranzicionale;
- Të hartojnë politika editoriale për qasjen e tyre në raport me drejtësinë tranzicionale; dhe
- Të kujdesen të shmangin gjuhën mono-etnike dhe të përfshijnë të dhënat e plota për numrin dhe etninë e të gjitha viktimave.



IN UNITY
WE PROSPER